

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
ZYRA E KRYEMINISTIT - QED PREMİERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI U ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVI Sektori	
Nr. i fakteve Nr. dokumenta Nr. Dokument	<u>04</u>
Ngjarje Events Geschehnisse	<u>80</u>
Mr. President Premier Minister Minister of State	<u>1059/13</u>
Date: Datum: Date:	<u>10/04/2018</u>
Prishtinë/a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

*Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs*

DATË/A:	06.04.2018
REFERENC-Ë:	<u>19/18</u>
PËR:	z. Ramush Haradinaj, kryeminister
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	amb. Anton Berisha, zëvendësminister, MPJ <u>A</u>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti 100 ditor

Inderuari kryeminister z. Haradinaj,

Duke Ju shprehur konsideraten time më të lartë, ju dërgoj "Raportin 100 ditor të punës"

Detyrën e zëvendësministrit të jashtëm në kuadër të Qeverisë së Kosovës, e kam marrë me datën 25 tetor 2017.

Në takim dhe në diskutim të hapur me kryeministrin z. Haradinaj, kam marrë përgjegjësin e detyrës me qëllimin e mirë të një angazhimi të plotë, konstruktiv dhe kompetent për nevojat e qeverisë dhe të vendit në përgjithësi.

Paraqitjen e parë në zyrë e kam bërë me datën 27 tetor 2018. Fillimisht ju kam drejtuar zyrës së ministrit z. Pacolli e më pastaj kam kryer procedurat administrative konform udhëzimeve administrative dhe diplomatike.

Duke marrë parasysh faktin e angazhimit të mëhershëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në detyrën e ambasadorit, akomodimi administrativ, diplomatik por edhe ndërnjerëzor me stafin ka shkuar lehtë e mirë.

A  
S

Hapi i pare, ka qenë takimi me ambasadorët të angazhuar në drejtoritë përkatëse, që nga Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtorët tjérë përkatës, me udheheqësit e dikastereve administrative e financiare, dhe me stafin tjetër për të marrë informata të plota përgjendjen e përgjithshme në ministri si dhe përgjendjen nëpër misione diplomatike.

Hapi i dytë, ka qenë njoftimi i diplomatëve të akredituar në Kosovë, që pastaj është shoqëruar me takime me ambasadorët ose diplomatë të rendit më të ulët, qoftë duke i pritur në zyrën time qoftë edhe në vet ambasadat e këtyre shteteve. Të gjitha takimet ishin miqësore, konstruktive dhe me vullnet të mirë bashkëpunimi.

Duke marr parasysh përmbledhjen e të gjitha informatave, i kam prezentuar ministrit z. Pacolli, pikëpamjet e mia për politikën e jashtme dhe angazhimin tim brenda ministrisë, bazuar në përvojën e ambasadorit që të angazhohem në raport me misionet diplomatike pasi që isha i vetmi nga zv.ministrat me një përvojë të tillë dhe me mundësi të të kuptuarit praktik të çeshtjeve që përballeshin ambasadorët, stafi diplomatik dhe misionet në tërësi.

Ministri z. Pacolli, me datën 16 nëntor 2017, ka dërguar një shkresë në adresë të zv.ministratave(Doc1-shfesë) në të cilën ka kërkuar që agjenda e takimeve të zv.ministrave paraprakisht të aprovohet nga ai, që praktikisht nënkuoncepte, në rastin konkret timin, të mos takoj ambasadorë dhe diplomatë pa aprovimin e Tij.

Kjo kërkesë, në praktikë është bërë pengesë për kryerjen normale të takimeve dhe kontakteve për shkak të mosprezencës së ministrit brenda në Kosovë dhe ka ulur intensitetin e bashkëpunimit me ambasadat, që në gjykimin tim nuk shkonte në favorin e MPJ. Për hir të klimës së mirë, unë i jam përshtatur kësaj kërkesë, megjithë faktin se në mungesë të detyrave të deleguara nga ministri, redukimin e aktiviteteve në nisiativë e kam konsideruar jondihmues.

Ministri, z. Pacolli, ka dërguar shkresën Nr.151 (docII-shtesë), në të cilën ka ndarë detyrat për zv.ministrat. Ndarja ka qenë joproportionale dhe favorizuese.  
z.Pacolli në këtë letër ka injoruar faktin e gatishmërisë sime për të marr përgjegjësi rrëth misioneve diplomatike duke i ndarë më shumë përgjegjesi zv.ministres Vuniqi, një zonjë dhe kolege e nderuar, por në mënyrë evidente e pa asnjë eksperiencë në atë fushë.

Konform detyrave të marra në fushën e NATO-s dhe Politikat e Sigurisë, kam punuar dhe zhvilluar të gjitha aktivitetet të dokumentuara në MPJ.

Është për t'u evidentuar që Departamenti per NATO dhe Politika te Sigurise ka zhvilluar një aktivitet dhe punë në nivel të lartë profesional, e në mënyrë të veçantë duhet theksuar udhëheqjen profesionale dhe të disiplinuar nga ambasador Ilir Dugolli.

Me kalimin e kohës ministri z. Pacolli, ka redukuar deri në paralizim të plotë të komunikimit, duke mos ndarë detyra dhe duke redukuar angazhimet e zv.ministratave dhe



praktikisht duke i deleguar të gjitha kompetencat, aktivitetet dhe komunikimet tek zv.ministrja Vuniqi.

Moskomunikimi total, mosnjoftimi për asnjë çështje dhe pamundësimi për të marr pjesë në aktivitet e MPJ-së, të vetmin interpretim mund të ketë dëmtimin e MPJ-së dhe privatizimin e çështjeve shtetërore.

Kabineti i ministrit, ndonëse i kam kërkuar disahere për bashkëpunim dhe kooperim, ka qenë i pamundur për t'u kontaktuar e lëre më për ndonjë konsultim apo vendimarrje.

#### VATIKANI

Konform letrës së kryeministrit z. Haradinaj, dërguar Nuncit Apostolik Juliusz Janusz (DocII-shtesë), për rolin tim si zv. Ministër në MPJ të kemi portofolin e koordinimit me Selinë e Shenjtë, kam zhvilluar kontakte me shkrim ( DocIV-shtesë) dhe takime me zyrtarët e shtetit të Vatikanit, fillimisht me Nuncin Apostolik Juliusz Janusz e pastaj edhe me zyrtarët ijerë duke përfshirë edhe vizitën në Vatikan me nënsekretatin e shtetit mons. Antoine Camilleri.

Në këtë kuadër, kam marr ftesë zyrtare nga Vatikan, që së bashku me bashkëshortën, të marr pjesë në Meshën e Kërshëndellave, me 24.12.2017, që fuste Kosovën në pjesëmarrjës protokolar së bashku me shtetet tjera që u përfaqësuan aty në nivele shtetërore dhe diplomatike.

Në vizitën zyrtare që kam zhvilluar në Vatikan, me datën 12 Janar 2018, me nënsekretarin e shtetit mons. Antoine Camilleri, jemi dakorduar për bashkëpunim, takime të rregullta dhe informim reciprok rrëth zhvillimeve e në mënyrë të veçantë për trajtimin e temave dhe zhvillimeve në Kosovë dhe në rajon.

Në vizitën e ministrit të Kosovës në Itali, e në të njëjtën kohë në Vatikan, datë 25 janar 2018, z.Pacolli në delegacionin 6 anëtarësh nuk më ka përfshirë mua, duke injoruar vendimin e kryeministrit z.Haradinaj për detyrimet e marra nga ai si kryeministër i vendit.

Me datën 7 Shkurt 2018 kam takuar në Lublanë, nuncin apostolic Juliusz Janusz i cili më ka njofltuar për takimin e z.Pacolli me sekretarin e shtetit Paul Richard Gallagher.

Nunci ka shprehur cudinë në kërkesën e ministrit Pacolli për vizitë ad-hoc, si dhe ka shprehur cudinë se si ai ka mohuar shkresën e kryeministrit dhe ka prezantuar një person tjetër duke krijuar paqartësi dhe huti tek zyrtarët e Vatikanit. Qëndrimi i Selisë se Shenjtë, sipas Nuncit éshtë komunikimi dhe respektimi i shkresës zyrtare të kryeministrit deri te ndonjë njoftim tjetër.

Në mënyrë evidente vizita ad-hoc e ministrit z.Pacolli ka krijuar një paqartësi dhe dëmtim të raporteve të cilat kishin marrë rugë të mirë dhe në minimum, ka shtyrë organizimin e vizitës së kryeministrit z. Haradinaj në Vatikan, e cila në parim ishte dakorduar gjatë vizitës time dhe takimit më nënsekretarin mons. Camilleri datë 12 Janar 2018.



## PËRFUNDIM

Ministri i Jashtëm në MPJ, z.Pacolli, duke mos bashkëpunuar dhe bashkërenduar aktivitetet, duke mos ndarë detyra e duke mos informuar për zhvillimet ka redukuar rolin e zv.ministrat në një vëzhgues të zakonshëm që është informuar përmes mediave ose përmes mundësive individuale. Aq me këq, përmes shkresave, ai ka kërkuar edhe kufizuar edhe ato veprimit që i kemi kryer.

Në shkresën e 16 shkurtit (docV-shtesë), sic mund të shihet në përbajtjen e saj, në 10 vjetorin e Pavarësisë, ministri z. Pacolli nuk e ka parë të arsyeshme as të na takoj, as të ndaj ndonjë detyrë e as së paku të uroj. Kjo qasje e pasembullt, edhe në traditën shqiptare të mosurimit e as në traditën institucionale, është tregues i nivelit më të ulët të respektit dhe bashkëpunimit.

Kjo cështje duhet adresuar, ashtu sic e parasheh udhëzimi administrativ, Rregullore Nr.02/2011, PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE, Neni 13 dhe Neni 14

Ministria e Punëve të Jashtme është resurs shtetëror dhe detyrimet e zyrtarëve të saj janë të përcaktuara dhe konform tyre dhe praktikave të mira sidomos të vendeve demokratike perendimore.

Ministria e Punëve të Jashtme ka profesionistë të shkëlqyeshëm të cilët janë të dedikuar për të punuar profesionalisht e singerisht, që respektojnë hierarkinë dhe të cilët kanë bashkëpunuar me mua si diplomatë të rryer. Fatkeqësisht, ndarja e detyrave dhe ndërhyrja e kabinetit të ministrit në punën e tyre ka penguar rrjedhën funksionale e strukturore si dhe ka krijuar huti në ndërveprim dhe komunikim.

---

\*Referimi në shumës: "zv.ministrave" është bërë në konsultim me zvm, z.Besnik Hoti

\*\* Kësaj shkrese ia bashkangjesë dokumentet shtesë.

DocI, DocII, DocIII, DocIV, DocV

Kronologji – ndonëse aktivitetet janë të dokumentuara në MPJ, faqen zyrtare të saj në Web, si dhe në faqen time zyrtare Anton K. Berisha, një pjesë e selektuar e aktiviteteve janë evidentuar në kronologji.





doc I

**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Ministria e Punëve të Jashtme/Ministarstvo Inostranih Poslova  
Ministry of Foreign Affairs*

Prishtinë, 16 Nëntor 2017

Zëvendësministrave  
Ministria e Punëve të Jashtme

Të nderuar Zëvendësministra/e Vuniqi, Berisha, Hoti dhe Dedaj,

Duke shprehur konsideratat e mia më të larta për ju, si dhe referuar kërkesës së Kryeministrit z.Ramush Haradinaj, në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbajtur me datë 16.11.2017, ku siç jeni në dijeni është kërkuar nga të gjithë Ministrat që me qëllim të përballjes me dinamikën qeverisëse, të delegohen përgjegjësi të caktuara tek zëvendësministrat.

Përmes kësaj letre ju njoftoj se, që nga momenti i marrjes së detyrës nga unë, si Ministër i Punëve të Jashtme, konceptin tim të punës dhe qeverisjes e kam bazuar në parimin e efikasitetit, ligjëshmërisë dhe transparencës. Sipas konceptit të njëjtë të punës do të vazhdoj të punoj deri në përfundim të mandatit tim.

Në reaizimin e programit tim qeverisës, në përputhje edhe me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për mandatin 2017-2021, ka shumë rëndësi edhe bashkëpunimi dhe puna jonë e përbashkët, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të qojmë përrpara politikën e jashtme dhe rrjedhimisht t'a fuqizojmë shtetin tonë.

Sa më sipër, kërkoj nga ju bashkëpunim, transparencë dhe efikasitet në punën tuaj, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që veprimi juaj, në fushën e përgjegjësive dhe detyrave të cilat do të ju delegohën nga unë, të jetë veçanërisht në përputhje me Kushtetutën, Ligjet dhe nenet 12 dhe 13 të Rregullorës Nr.02/2011 *Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive*.

3

Në kontekst të kësaj, gjithashtu kërkoj nga ju që të më informoni paraprakisht dhe të merrni autorizimin tim për agjendën tuaj, si dhe për të gjitha takimet që do t'i zhvilloni në funksion të punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Koordinimi dhe angazhimi i përbashkët do të n'a ndihmojë për të shënuar më shumë suksese për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Republikën e Kosovës në përgjithësi.

Në vijim të punës tonë të përbashkët, në përputhje me detyrat e mia sipas Kushtetutës, Ligjit dhe aktëve të tjera nënligjore, unë do të ju deleoj me shkrim autorizime dhe përgjegjësi konkrete, për të cilat do të ju informoj shumë shpejt.

Ju faleminderit.

Me respekt,

Behgjet Pacolli

Zëvendëskryeministër i Parë &

Ministër i Punëve të Jashtme



doc II



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs

Zyra e Ministrit - Kancelariju Ministra - Cabinet Of The Minister

Date: 22 / 01 / 2017

No. 454

Në bazë të nenit 93 (paragrafi 4) i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenëve 8, 12 dhe 13 të Rregullores Nr.02/2011 përfushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrat dhe Ministrive, bazuar në vendimet e Kryeministrat të Republikës së Kosovës për emërimin e zëvendësministrave në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministri i Punëve të Jashtme nxjerr:


**Udhëzim për dhënien e autorizimeve dhe përcaktimin e fushave, për ushtrimin e detyrave  
të zëvendësministrave në Ministrinë e Punëve të Jashtme**

- I. Ky akt ka përfshillë përcaktimin e fushave dhe dhënien e autorizimeve, për kryerjen e detyrave të zëvendësministrave në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- II. Përcaktimi i detyrave, dhënia e autorizimeve dhe ndarja e fushave në kryerjen e detyrave nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Jashtme bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme, bazuar në prioritetet dhc politikat qeverisëse të Qeverisë.
- III. Fushat e angazhimit, dhënia e autorizimëve dhe ndarja e përgjegjësisve të zëvendësministrave në Ministrinë e Punëve të Jashtme bëhet si vijon:
  - 1) Zëvendësministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Znj. Rejhan Vuniqi angazhohet në fushën e Diplomacisë Ekonomike dhe marrëdhënieve me Misionet Diplomatike;
  - 2) Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Z. Anton Berisha angazhohet në fushën e marrëdhënieve me NATO-n dhe Politikat e Sigurisë;
  - 3) Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Z. Besnik Hoti angazhohet në fushën e marrëdhënieve me Organizatat Ndërkombëtare;
  - 4) Zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Z. Gjergj Deda angazhohet në fushën e marrëdhënieve Rajonale.

- IV. Zëvendësministrat duhet t'i përbahen fushave të angazhimit të tyre, të përcaktuara me këtë akt, si dhe autorizimet e tyre në këto fusha t'i ushtrojnë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Punëve të Jashtme.
- V. Përveç fushave të përcaktuara në këtë akt, zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të ushtrojnë edhe autorizime dhe detyra të tjera të cilat i caktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.
- VI. Zëvendësministrat nuk mund të ushtrojnë autorizime dhe detyra në fushat e përcaktuara sipas këtij akti, vetëm në rastet kur këto autorizime dhe detyra ushtrohen drejtëpërdrejtë nga Ministri i Punëve të Jashtme.
- VII. Në ushtrimin e detyrave dhe autorizimeve të tyre, sipas fushave të përcaktuara në këtë akt, zëvendësministrat duhet të koordinohen në vazhdimësi me Ministrin e Punëve të Jashtme, për punën, veprimet si dhe qëndrimet publike të tyre, me qëllim që krijimit të standardeve uniforme të politikave në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- VIII. Në koordinim me Ministrin e Punëve të Jashtme, obligohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, departamentet dhe zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme që të mbështesin zëvendësministrat në kryerjen e punëve dhe ushtrimin e detyrave dhe autorizimeve, sipas fushave të përcaktuara në këtë akt.
- IX. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Jashtme.
- X. Ky udhëzim i shpërndahet të gjitha palëve të interesit, përmes zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.



N



doc III

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Zyra e Kryeministrit / Urdet Premijera / Office of the Prime Minister  
Kabinet i Kryeministrit - Kabinet Premijera - The Cabinet of The Prime Minister

Prot. Number: 179/2017  
Date: 10. 11. 2017

Archbishop Juliusz Janusz,  
Apostolic Nuncio  
Vatican Apostolic Nunciature in Ljubljana  
Apostolic Delegate to Kosovo

Your Excellency,  
Dear Archbishop,


Please allow me to express my profound compliments to You as the Apostolic Delegate to Kosovo, using this opportunity to invite you for an official visit to Kosovo.

I would like to use of this opportunity to inform You Excellency that I have appointed deputy Minister of Foreign Affairs, Ambassador Anton Berisha. His principal portfolio is focused in cooperation with the Holy See.

Excellency, please allow me to benefit of this opportunity to renew the assurance of my highest consideration.

*Ramush Haradinaj*  
Respectfully,  
Ratnush Haradinaj  
Prime Minister of the Republic of Kosovo

*A3*



NUNTIATURA APOSTOLICA  
IN SLOVENIA

doc IV

Ljubljana, 28 November 2017

N. 1704/17

Your Excellency,

I have learned with great satisfaction that the Prime Minister of the Republic of Kosovo, H.E. Mr. Ramush Haradinaj, has appointed you as Deputy Minister of Foreign Affairs. I certainly recall previous occasions in which we have met and discussed matters concerning my position as Apostolic Delegate for Kosovo and the present status of cooperation between Kosovo and the Holy See.

It will be a pleasure to meet you again, whenever You might visit Ljubljana or otherwise in Kosovo.

While congratulating you for this honorable appointment I take this opportunity to assure you of my highest esteem and wish you all success in the coming activity

+   
Archbishop Juliusz Janusz  
Apostolic Delegate for Kosovo

---

His Excellency  
Mr. Ambassador Anton Berisha  
Deputy Minister of Foreign Affairs  
Republic of Kosovo  
Prishtinaë  
KOSOVO





doc ✓

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministerstvo Inostranih Poslova  
Ministry of Foreign Affairs

Prishtinë, 16 Shkurt 2018

Zëvendësministrave  
Ministria e Punëve të Jashtme


Të nderuar Zëvendësministra/e Vuniqi, Berisha, Hoti dhe Dedaj,

Duke shprehur konsideratat e mia më të larta për ju, përmes kësaj letre ri theksoj edhe njëherë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta të politikës së Jashtme, në kuptim të ushtrimit të kompetencave tuaja.

Gjatë gjithë kësaj kohe të punës së përbashkët në vazhdimësi kam vërejtur në raste të caktuara mos koordinimit në mes të aktiviteteve të mia si ministër dhe aktiviteteve tuaja, si pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Madje në disa raste kam përshtypjen që kemi treguar edhe një nivel të jo seriozitetit. Në këtë aspekt do të theksoja veçanërisht mos koordinimin për shumicën e udhëtimeve dhe takimeve që keni pasur Jashtë shtetit.

Duke pasur parasysh këtë situatë të krijuar kërkoj nga ju që tani e tutje, me rastin e zhvillimit të takimeve dhe vizitave tuaja jashtë shtetit, të konsultoheni paraprakisht me mua, me qëllim që të bashkërendojmë veprimet qeverisëse dhe çështjet tjera relevante.

Sic jeni në dijeni, rregullat në fuqi të funksionimit të Qeverisë dhe Ministrive, përcaktojnë qartë rolin qeverisës të ministrit dhe të zëvendësministrave në një Ministri, andaj pres që kjo kërkesë e imja të respektohet tërësisht nga ana juaj, në të kundërtën do të veproj sipas obligimeve ligjore.

  
Me respekt,  
Behgjet Pacolli  
Zëvendëskryeministër i Parë &  
Ministër i Punëve të Jashtme

BS

**Kronologjji** — Ndonëse aktivitetet janë të dokumentuara në MPJ, faqen zyrtare të saj në Web, si dhe në faqen time zyrtare Anton K. Berisha, një pjesë e selektuar e aktiviteve janë evidentuar në kronologji.

23 Nentor 2017

Prita në takim Drejtorin e Caritas-it të Kosovës, don Viktor Sopi me bashkëpunëtorë.

27 Nentor 2017

Prita në takim ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, zonj. Marija Kapitanović

27 Nentor 2017

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, ambasador Anton Berisha, priti në takim ambasadorin e Hungarisë Lazlio Márkus dhe zëvendësambasadorin Bela Bozsik.

29 Nentor 2017

Me ftese te Delagatit Apostolik per Kosoven, Arqipeshkvit Juliusz Janusz, Nunciatura Apostolike ne Lubjane, eshte vizituar nga zevendësministri i Puneve te Jashtme, ambasadori Anton Berisha.

30 Nentor 2017

Ne vazhdim te vizites ne Slloveni, se bashku me ambasadorin tone z.Nexhmi Rexhepi, kemi takuar Drejtorin per Politike te Jashtme dhe Siguri, ambasadorin Matej Marn.

5 Dhjetor 2017

Pjesëmarrje, SEMINAR: "Importance of the Foreign and Security Policy Alignment of the aspirant countries with EU's CFSP. Challenges and opportunities.

8 Dhjetor 2017

Se bashku me bashkepunetore nga Ministria e Jashtme, drejtoret perkates, kam pritur autoret e Raportit që synon të eksplorojë mënyrat se si shtetet anëtare të BE-së angazhohen me Kosovën:  
James Ker-Lindsay – Profesor i politikës dhe politikave në Universitetin St. Mary's, Twickenham dhe vizitor i lartë studimesh (Senior Visiting Fellow) në London School of Economics; Ioannis Armakolas – Asistent profesor në Departamentin e Studimeve ballkanike, sllave dhe orientale – Universiteti i Maqedonisë, Selanik dhe Drejtues i Programit për Evropë Juglindore në Fondacionin Helen për Politika Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP); Agon Demjaha – Asistent Profesor i shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare – Universiteti shtetëror i Tetovë dhe perfaqesuesit tjere te ketij raporti; në drejtimin e Luan Shllaku – KFOS.

13 Dhjetor 2017 Takim me Shefin e Zyres Nderlidhese të NATO-s në Shkup, z. Gorazd Bartol  
( Në kuader të Takimit Ministror të Partneritetit SHBA - Karta e Adriatikut, që është duke u mbajtur në Shkup)



13 Dhjetor 2017

Pjesmarria ne takimin Ministror te NATO-s, Partneriteti SHBA- Karta e Adriatikut;  
Zv/kryeminisitri dhe ministri i MPJ, z. Behgjet Pacolli;  
ambasadorin tone ne Shkup, z. Ylber Hysa,  
drejtorin per NATO dhe ceshtje te sigurise, ambasador Ilir Dugolli

15 Dhjetor 2017

Takim me perfaqesuesit e BE-se te kryesuar nga Pedro Serrano Dep/SG

19 Dhjetor 2017

Vizite zyrtare ne Silloveni, ne delegacionin e udhehequr nga zevendeskryeministri i pare dhe ministri i puneve te jashtme, z. Behgjet Pacolli.

Takim me ministrin e puneve te jashtme te Sillovenise, z. Karl Erjavec.

Takim me presidentin z. Borut Pahor

12 Janar 2018

Vizite në Vatikan

Në Sekretarinë e Vatikanit, jam pritur nga nënsekretari për marëdhënie me shtetet, monsinjor Antoine Camilleri.

15 Janar 2018

EINDHOVEN - HOLANDË

Koncerti : MESHA E PAQES (Njeriu me armë)

Me ftese te autoriteteve holandeze, së bashku me amb. Vjosa Dobruna, ishim të ftuar nderi në koncertin 'Mesha e Paqes' që u mbajtë në Muziekgebouw në Eindhoven.

18 Janar 2018

Së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm amb. Albert Prenkaj ka pritur në takim ambasadorin e Çekisë, Ivo Šilhavy dhe zëvendësin Dusan Kralik.

1 Shkurt 2018

Në Podgoricë - Konferenca Regionale e Nivelit te Larte, SALW CONTROL - Kontrolli i Armeve dhe çarmatimi' - me mbeshtetje te Qeverise Federale te Gjermanise.

2 Shkurt 2018



Vizitë nga senatori Italian SONEGO

Pritja e kryetarit të delegacionit parlamentar italian në Iniciativën Qendrore Evropiane (CEI), senatorin z.Lodovico Sonego.

5 Shkurt 2018

Vizitë nga shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Jan Braathu.

12 Shkurt 2018

Vizitë nga sekretari i shtetit të Shqipërisë, ambasadori Iztok Mirošić.

20 Mars 2018

Takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme të Belgjikes, të kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme zonj.Anick Van Calster,

28.11.2017-01.12.2017- Vizit nunciature në Lubjanë, delegatit për Kosovën.

12.12.2017-13.12.2017- US Adriatic Charter Partnership Commission Meeting, Maqedoni.

18.12.2017-20.12.2017- Lubjanë.

23.12.2017-25.12.2017- Ftesë nga Selia e Shenjtë për pjesëmarrje në meshën e Krishtlindjes nga Papa Francesku.

11.01.2018-15.01.2018-Takim në Sekretarine e shtetit në Vatikan/pjesëmarrja në Hage "Viktimat e Kosovës".

30.01.2018- Takim me Arqipeshkvine e Shkodres.

31.01.2018-02.02.2018- Pjesëmarrje në Konferencen e "High Level Conference on Small Arms and Light Weapons Control" të organizuar në SEESAC në Podgoricë.

06.02.2018-08.02.2018- Me 7 shkurt takim me Nuncin – Lublane / pjesëmarrje në pritjen e ambasades Kroate- Zagreb.

10.02.2018-11.02.2018- Pjesëmarrje në meshen Shenjtë në Katedrale – Tiranë.

20.02.2018-21.02.2018- Takim në Arqipeshkvi me Arqipeshkvin e Shkodres Imzot Masafra.

25.02.2018-27.02.2018- Pjesëmarrje për 10 Vjetorin e Pavarsisë, Vjenë.

28.02.2018-02.03.2018- Takime në Vatikan.

28.03.2018-29.03.2018- Konsultim me Ipeshkvin para takimit me Nuncin.

